



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Nr. Org. Org. Jedinite Org. Unit	51-02	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	85-2/20
Nr. i faqeve Broj stranca No pages	- 03 -	Data Datum Date	29.01/2020
Prishtinë / a			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	20.01.2020
<b>REFERENC-Ë:</b>	20/85/1 - 35/ DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kompania "Pegasus"sh.p.k. Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Autorizim Mjedisor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka pranuar kërkesën me nr.prot.: 20/85/1 - 35/ DMMU për Autorizim Mjedisor dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Autorizim Mjedisor Lidhur me asgjësimin e mbeturinave nga produktet medicinale

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

Në bazë të nenit 33 paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**  
**Për Autorizim Mjedisor**

APROVOHET kërkesa e kompanisë “Pegasuss”sh.p.k. Prishtinë për Autorizim Mjedisor për asgjësimin e mbeturinave nga produktet medicinale.

**A r s y e t i m**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 03/15 për Autorizim Mjedisor, ka shqyrtuar kërkesën e dorëzuar, të kompanisë Kompania “Pegasuss”sh.p.k. Prishtinë, për Autorizim mjedisore lidhur me shkatërrimin e mbeturinave medicinale – barnave – në sasi prej (peseqinte) 500 kg, të specifikuar në listën e bashkangjitur kërkesës, në kompaninë „Princi Company” Sllatine Fushë Kosovë, vlerëson si vijon:

Në shkresën nr. prot. 20/85/1-35/ DMMU, datë: 10.01.2020 në të cilën kërkohet të i lejohet asgjësimi i mbeturinave farmaceutike, në lloj dhe sasi të specifikuar në listën e bashkangjitur kërkesës për Autorizim Mjedisor nga aplikuesi, sipas kontrates me kompaninë „Princi Company” Sllatine Fushë Kosovë, behet asgjësimi i produkteve mbeturinave medicinale.

Gjithashtu, kërkohet të i lejohet asgjësimi e mbeturinave nga produktet medicinale me afat të skaduar, në lloje dhe sasi të specifikuar në listën e bashkangjitur kërkesës për Autorizim Mjedisor nga aplikuesi.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)



Sipas nenit 29 të ligjit për mbeturina Nr. 04/L-060, Trajtimi termik i mbeturinave bëhet në impiante të cilat janë të projektuara, të ndërtuara dhe të pajisura në bazë të këtij Ligji, përkatësisht sipas dispozitave të kapitullit IX të Udhëzimit Administrativ Nr. /2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizëshme të ndotjes.

Bazuar në argumentet e lartcekura, komisioni për Autorizim Mjedisor propozon që të i jepet Autorizimi Mjedisor për asgjësimin e sasisë së mbeturinave, të propozuar sipas listës së mbeturinave farmaceutike, në kompaninë „Princi Company” Sllatine Fushë Kosovë që posedon impiantin në të cilin temperatura e furrës së impiantit duhet të jetë sipas dispozitave të udhëzimit administrativ nr. 10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale.

Mbeturinat medicinale të digjen, me kujdes të veçantë duhet të mbahet për mbeturinave farmaceutike që janë të ambalazuara në bombola, të cilat nuk do të hudhen për djegie, për shkak mundësive për eksplozimin e tyre.

Kompania “Pegasuss”sh.p.k. Prishtinë, me nr. regj. Biznesit 810791865, duhet të njoftoj Inspektoratin e MMPH-së, shtatë - (7) ditë para fillimit të punëve në lidhje me asgjësimin e mbeturinave sipas këtij vendimi, në mënyrë që të jetë nën mbikëqyrje, të inspektoratit të MMPH-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, Autorizimi Mjedisor do të anulohet.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 20/85/1-ZSP/ 28/20 datë: 20.01.2020

Prishtinë

T’i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit në DMMU/DMK
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrisë
5. Arkivit të MMPH-së



Faqe 3 nga 3

**Kompania: "Pegasuss"sh.p.k. Prishtinë**

Rr. Miladina Stevica p.n. Gracanice

Driton-hyseni@pegasus-united.com

Mob. 045 880 885